



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË  
FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT  
TË UJËRAVE TË NDOTURA  
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR

VENDIM  
Nr.122, datë 20.10.2020

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS KANALIZIME KUKËS SH.A.**

Në mbështetje të nenit 13, 14, 15, 16 dhe 17 të ligjit nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (**Ligji nr. 8102**), VKM nr. 958, datë 06.05.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence" (**VKM nr.958**), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29 datë 08.12.2009 "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar (**Rregullore e licencimit**),

**Komisioni Kombëtar Rregullator,**

Në mbledhjen e datës 20.10.2020 pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike dhe Drejtoria Juridike dhe e Konsumatorit mbi kërkesën e shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Kukës sh. a për licencim

**Vëren se:**

1. Shoqëria Ujësjiellës Kanalizime Kukës (**UK Kukës**) me shkresën nr. 397 prot. datë 01.09.2020, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (**ERRU**) kërkesën për rinovim licence për shkak të mbarimit të afatit.
2. Komisioni Kombëtar Rregullator (**KKRR**) e gjeti paraqitjen e kërkesë për licencim për shkak të mbarimit të afatit të UK Kukës në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe Rregulloren e licencimit, si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM nr. 63 datë 27.01.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura" (**VKM nr. 63**).
3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:
  - a) UK Kukës ka përditësuar ekstraktin e regjistrit tregtar për shkak të riorganizimit të shoqërisë sipas parashikimeve të VKM nr. 63;

- b) Shoqëria UK Kukës ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 35 845 banorë në Bashkinë Kukës;
  - c) Drejtuesja teknike e shoqërisë UK Kukës sh.a. plotëson kërkesat e VKM nr. 958 mbi edukimin dhe eksperiencën në profesion.
4. ERRU në vlerësimin e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Kukës, të:
- a) Kërkesave të ligjit nr. 8102 si dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, efikasitetin, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;
  - b) Kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës” të ndryshuar, (**ligji nr. 9121**) për mos lejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve;
5. ERRU, në bazë të vlerësimit dhe verifikimeve të kërkesës së shoqërisë UK Kukës rekomandon:
- Shoqëria UK Kukës duhet të aplikojë pranë ERRU për miratimin e tarifave largimit të ujërave të ndotura për të gjithë zonën e shërbimit;

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Kukës është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

#### **VENDOSI:**

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Kukës sh.a me NUIS J67902228S në kategoritë:
  - a) Kategoria A - Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik
  - b) Kategoria C - Për largimin e ujërave të ndotura
2. Shoqëria Ujësjellës Kanalizime Kukës sh.a autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:
  - a) Drejtues Ligjor – Asllan Hoxha
  - b) Drejtuese Teknike –Hazbije Onuzi
3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Kukës sh.a është Bashkia Kukës.
4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4 vjeçare.

5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Kukës sh.a detyrohet të nënshkruajë Kushtet e Licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.
6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime Kukës sh.a për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.  
Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR**  
**Ndriçim Shani**